

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS - UNIVERSITETSKA BOLNIČKE I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA - THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO	
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE	
Nr. i njësisë shq.	Nr. Prot.
org. jed	Prot. prot.
org. unit	Prot. no.
Nr. i faq.	Data
Sr. str.	Datum
No. page	Date
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Në bazë të nenit 45 paragrafi të Ligjit Nr.04/L-125 ~~Për Shëndetësi dhe në~~ mbështetje të nenit 12 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), në mbledhjen e mbajtur më 23 / 05 / 22, nxjerr këtë:

RREGULLORE NR ____ PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE ORGANIZIMIN E PRAKTIKES KLINIKE DHE USHTRIMET PËR INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË NË SHËRBIMIN SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktojë formën dhe procedurën për realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve në njësitë përbërëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) sipas statutit.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë rregullore rregullohen kushtet për organizimin e praktikës klinike dhe të ushtrimeve për studentët e Institucioneve private të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës në SHSKUK.

Neni 3

Përkufizime

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. SHSKUK – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës;

1.2. Statuti – Statuti i SHSKUK-së;

1.3. Institucion privat i Arsimit të lartë – Çdo institucion privat i arsimit të lartë i licencuar dhe i akredituar sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës;

1.4. Njësitë përbërëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Njësitë përbërëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar sipas statutit;

1.5. Personi përgjegjës për koordinimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve – Personi që ka për kompetencë koordinimin dhe mbikëqyrjen e organizimit të praktikës klinike dhe ushtrimeve;

1.6. Mentori klinik – Personi që mbikëqyr dhe mentoron studentët gjatë organizimit të praktikës klinike.

Neni 4

Praktika klinike dhe ushtrimet në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

1. SHSKUK mundëson realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për të gjithë studentët e institucioneve private të arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës.
2. Praktika klinike dhe ushtrimet sipas paragrafi 1 të këtij neni organizohen dhe realizohen në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së.
3. Praktika klinike dhe ushtrimet sipas këtij neni realizohen sipas planit të punës së njësisë përkatëse në kuadër të SHSKUK-së.

Neni 5

Përgjegjësitë e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

1. SHSKUK ofron kushtet e nevojshme që ka në dispozicion, për realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve sipas kësaj rregullore.
2. Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK në bashkëpunim me Drejtorin për Arsim dhe Shkencë caktojnë personin përgjegjës për koordinimin dhe mbikqyrjen e realizimit të praktikës klinike dhe ushtrimeve.

Neni 6

Mentorët klinik

1. Mentorët klinik që angazhohen në pajtim me këtë rregullore duhet të jenë në marrëdhënie pune me SHSKUK.
2. Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK miraton listën e mentorëve klinik të propozuar nga Institucioni Privat i Arsimit të Lartë përkatës.
3. Emërimi i mentorëve duhet bëhet 15 ditë para fillimit të semestrit.
4. Institucioni Privat i Arsimit të Lartë ka obligim që të paguajë secilin mentor klinik në përputhje me orët e angazhimit.

Neni 7

Organizimi i praktikës klinike dhe ushtrimeve

1. Institucionet private të arsimit të lartë lidhin marrëveshje me SHSKUK për mbajtjen dhe organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve.
2. Numri i studentëve që kryejnë praktikë klinike dhe ushtrime në SHSKUK përcaktohet me vendimin përkatës të Agjencionit Kosovar për Akreditim.
3. Praktika klinike dhe ushtrimet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës organizohen pas përfundimit të orarit të rregullt të punës (07:00-15:00).
4. Praktika klinike dhe ushtrimet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës mund të organizohen çdo ditë duke filluar nga ora 15:00 deri në orën 20:00. Në njësitë tjera përbërëse të SHSKUK-së, orari i mbajtjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve përcaktohet nga vetë njësia përkatëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e Institucioneve private të arsimit të lartë

1. Bartësit e institucioneve private të arsimit të lartë hartojnë listën e studentëve që do të zhvillojnë praktiken klinike dhe ushtrimet në SHSKUK.
2. Studentët janë të obliguar që të vijojnë me rregull praktiken klinike dhe ushtrimet sipas planit të punës së njësisë përkatëse të SHSKUK.
3. Studentët e Institucioneve private të arsimit të lartë, në rast se me qëllim ose nga pakujdesia shkaktojnë dëm në SHSKUK, atëherë institucioni privat përkatës është i obliguar që të kompensojë shumën e dëmit të shkaktuar në tërësi.
4. Institucioni Privat i Arsimit të Lartë është përgjegjës për kompensimin e të lënduarit përkatësisht trajtimin e sëmundjes së tij të cilin studenti/ja e ka fituar gjatë realizimit të praktikës klinike apo ushtrimeve në SHSKUK.

Neni 9

Kushtet e veçanta për realizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

1. Praktika klinike dhe ushtrimet për studentët e institucioneve private të arsimit të lartë në SHSKUK organizohet me pagesë.
2. Pagesa nga paragrafi 1 i këtij neni realizohet si kompensim për praktiken klinike dhe ushtrimet në SHSKUK.
3. Pagesa sipas këtij neni realizohet në llogari të SHSKUK dhe kategorizohet sipas programit të studimeve.
4. Studentët e institucioneve private të arsimit të lartë gjatë kryerjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve janë të obliguar që të kenë me vete uniformën me logon e institucionit përkatës të tyre.
5. Për studentët e programit infermieri, mami, fizioterapi, logopedi, laborant, psikologji dhe radiologji të cilët kryejnë praktikë klinike në SHSKUK, Institucioni Privat i Arsimit të Lartë duhet ti paguajë SHSKUK –së shumën prej njëqinddhjetë (110) euro për një (1) student për një (1) vit akademik.
6. Për studentët e programit stomatologji të cilët kryejnë ushtrime në SHSKUK, Institucioni Privat i Arsimit të Lartë duhet ti paguajë SHSKUK-së shumën prej njëmijëpesëqind (1500) euro për një (1) student për një (1) vit akademik.
 - 6.1. Pagesa sipas këtij paragrafi vlen vetëm për studentët që kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK).
 - 6.2. Studentet e programit të stomatologjisë të cilën kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet në lëndët nga mjekësia e përgjithshme në SHSKUK, duhet të paguajnë shumën prej dyqind (200) euro për një vit akademik.
7. Për studentët e programit farmaci të cilët kryejnë praktikë ushtrime në SHSKUK, Institucioni Privat i Arsimit të Lartë duhet ti paguajë SHSKUK-së shumën prej (400) euro për një vit akademik.
8. Pagesa sipas këtij neni ndahet në dy semestra dhe realizohet para fillimit të semestrit përkatës.

9. Koha e realizimit të pagesës sipas këtij neni përcaktohet me marrëveshjen e lidhur mes palëve sipas kësaj rregulloreje, por detyrimisht duhet të përcaktohet në asi forme që praktika klinike dhe ushtrimet nuk mund të fillojnë pa u realizuar pagesa.

Neni 10

Sanksionet

1. Çdo veprim në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore konsiderohet shkelje dhe sanksionohet me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Çdo veprim në kundërshtim me Kodin Etik dhe Deontologjisë Mjekësore sanksionohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Mbikëqyrja

1. Autoritet mbikqyrës i zbatimit të kësaj rregullore janë:
 - 1.1 Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Drejtori për Arsim dhe Shkencë i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Drejtori i Klinikës dhe Koordinator i Infermierisë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
 - 1.2 Në Spitalet e Përgjithshme Drejtori Mjekësor.
 - 1.3 Në njësitë tjera të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, që nuk janë përmendur në nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, autoritet mbikëqyrës është Drejtori i njësisë.
 - 1.4 Personi përgjegjës sipas paragrafit 2 të nenit 5 të kësaj rregullore.

Neni 12


Dispozitat shfuqizuese

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimet për institucionet private të arsimit të lartë në shërbimin spitalor dhe klinik universitar të Kosovës nr.prot: 1464/5 të datës 08.10.2019.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga ana e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.


Prof.Ass.Dr.Aida Rexhepi
Kryesuesë e Bordit Drejtues, SHSKUK

